



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA DURRËS
DREJTORIA LIGJORE**

PROJEKTVENDIM

Nr. ____ DATË ____/____/202__

**PËR
MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROÇESIT TË
RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR.3, RRUGA "HYSEN
MYSHKETA", PALLATI NR. 25.1, I DËMTUAR NGA FATKEQËSIA
NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019.**

Në zbatim të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjit nr. 7850 datë 29.07.1994 "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë", të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Akti Normativ nr.9 datë 16.12.2019 "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me Ligjin nr. 97/2019, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.904, datë 24.12.2019 "Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.5, datë 06.01.2020 "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model" i ndryshuar, Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 202, datë 05.03.2020 "Për përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e vitit 2020, për financimin e rindërtimit të banesave individuale", Vendimit të Komisionit Shtetëror të Rindërtimit nr.104 datë 08.07.2022, Urdhërit nr. 164, datë 01.07.2020 "Për ngritjen e komisionit të posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e procesit të rindërtimit", i ndryshuar, të raportit të Komisionit të Posaçëm miratuar nga titullari i institucionit me nr. 14506 Prot., datë 12.12.2024, si dhe sipas relacionit të hartuar nga ky komision, kryetari i bashkisë i propozon Këshillit Bashkiak Durrës të shqyrtojë në përputhje me aktet ligjore dhe,

TË VENDOSË:

1. Miratimi i listës së përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit për pallatin Nr.25.1, Njësia Administrative Nr.3, Rruga "Hysen Myshketa", i dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019, sipas Aneksit nr.1, pjesë përbërëse e këtij projektvendimi.


2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Publike, Komisioni i Posaçëm dhe Zyra e Posaçme e Rindërtimit Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Durrës.

DREJTORIA LIGJORE

Drejtor

Alncida Broshi



KOMISIONI I POSAÇËM


Kryetar

Gentian Kallmi



KRYETAR

Emiriana Sako



neksi 1.

Nr.	PRONARI	GJENDJE FAMILJARE SIPAS ÇERTIFIKATES	STRUKTURA E APARTAMENTIT QË DO PËRFITOHE
1	PERPARIM RECI, VOJSAVA RECI	5	3+1
2	SOKOL FAMA	5	3+1
3	JORIDA DOCI, LEONARD BOLLO	4	2+1
4	FATMIR FARRUKU, SABRIJE FARRUKU	4	2+1
5	PRANVERA FERHATI, VANDAN, FERHATI	4	2+1
6	ADEL KORBI	3	2+1
7	NAXHIJE ISMAILI	1	1+1
8	IZET MANJANI, NAZE MANJANI	4	2+1
9	AFËRDITA REÇEKU, GËZIM REÇEKU	7	3+1
10	PETRIT KONI, BAJAME KONI	3	2+1
11	GENTIAN PINA, IRIS PINA	3	2+1
12	GENC GJERGJI, ROVENA GJERGJI	3	2+1
13	JURGEN KARATI	1	2+1
14	BUJAR PERVIZI, ENERJETA, PERVIZI	4	2+1



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KOMISIONI I POSAÇËM**

RELACION

**PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROÇESIT TË
RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR.3, RRUGA "HYSEN
MYSHKETA" PALLATI NR. 25.1, I DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E
TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019.**

Të nderuar këshilltarë

Sikurse jeni në dijeni, tërmeti i fuqishëm i rënë në datën 26.11.2019, që tronditi Shqipërinë, përfshiu edhe territorin administrativ të Bashkisë Durrës, ku janë evidentuar dëme të shumta ndërtimore në të gjitha Njësitë Administrative në juridiksionin administrativ të saj. Nisur nga kjo ngjarje natyrore, e cila krijoi një situatë të papritur me pasoja të rënda për banorët e Bashkisë Durrës, duke cënuar sigurinë e tyre dhe shkaktuar dëme të mëdha për jetën e njerëzve, Këshilli i Ministrave miratoi vendimin nr. 750, datë 27.11.2019, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë”, të ndryshuar, në të cilin ishte sanksionuar fakti se për përballimin dhe lehtësimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë, institucionet publike ishin të detyruara të merrnin masa të jashtëzakonshme për përballimin e kësaj shtate. Konkretisht, referuar pikës 7.1, shkronjat “a” dhe “d” institucionet publike duhej të realizonin plane masash organizative dhe administrative për përballimin e gjendjes së fatkeqësisë natyrore dhe ndihmojnë në përballimin dhe lehtësimin e saj.

Në vijim, Këshilli i Ministrave, me qëllim intensifikimin e masave dhe veprimeve për përballimin e pasojave të kësaj fatkeqësie natyrore, si edhe të fatkeqësive të tjera që për shkak të intensitetit, të shkallës dhe të shtrirjes së tyre, kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme të të gjitha institucioneve të mbrojtjes civile, miratoi Aktin Normativ nr. 9, datë datë 16.12.2019, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr.97/2019, i cili, ka si objekt kryesor të rregullojë funksionimin e organeve përgjegjëse për rehabilitimin dhe rindërtimin e komuniteteve dhe të territoreve të prekura nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera, si dhe zhvillimin e territoreve të reja, duke përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë e tyre, programet e procesit të rindërtimit,

funksionimin e fondit të rindërtimit dhe procedurat përkatëse, si dhe Vendimit të Komisionit Shtetëror të Rindërtimit nr.104 datë 08.07.2022.

Në zbatim të këtyre parashikimeve dhe në funksion të fillimit të zbatimit të programeve të procesit të rindërtimit, Këshilli i Ministrave miratoi një sërë aktesh në zbatim të Aktit Normativ, në të cilat u detajuan procedurat që duhet të ndiqen për secilin prej programeve, nga të cilat, më të rëndësishmet mund të përmendim vendimin nr. 904, datë 24.12.2019, “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit”, të ndryshuar.

Vendimet e sipërcituara, krahas përcaktimit të procedurave dhe rregullave për të përfituar nga disa prej programeve të lartpërmendura, parashikojnë detyrimin e kryetarit të bashkisë për ngritjen e Zyre të Posaçme të Rindërtimit për shqyrtimin e dosjeve dhe kualifikimin e tyre si dhe ngritjen e një Komisioni të Posaçëm që do të vlerësojë dhe shqyrtojë aplikimet për të përfituar nga programet e procesit të rindërtimit. Më specifikisht, detyrat konkrete të komisionit janë të përcaktuara në pikat e poshtëshënuara:

-Pika 8, e VKM-së nr. 904/2019: Kërkesat e plotësuara me të dhënat dhe dokumentacionin sipas parashikimit të këtij vendimi regjistrohen sipas rendit kronologjik në sistemin e posaçëm elektronik nga strukturat përgjegjëse. Regjistri i kërkesave për mbanin formacionin që mundëson përpunimin e të dhënave, si mëposhtë vijon: a) emrin, atësinë, mbiemrin; b) numrin e kërkesës; c) datën e dorëzimit/paraqitjes së aplikimit; ç) objektin e kërkesës, përfshirë edhe preferencën e paraqitur për programin e rindërtimit; d) adresën e kërkuarit; dh) përbërjen familjare në momentin e aplikimit; e) Aktin e konstatimit/akt ekspertizën e thelluar, të lëshuar nga çdo person fizikosejuridik, subjektisëdrejtëstregtare, ipajisur me lejen, licencën ose autorizimin përkatës nga autoritetet shtetërore për vërtetimin e gjendjes së rrezikut për jetën dhe shëndetin, në të cilin vërtetohen dëmet që ka pësuar ndërtesa apo që është shpallur si e pabanueshme; ë) dokumentin e pronësisë ose çdo akt përfitimitin e pronësisë së banesës së dëmtuar.

- Pika 16, e VKM-së nr. 904/2019: “Për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e procesit të rindërtimit, në bazë të kritereve të përcaktuara në këtë vendim dhe listës së objekteve të vëna në dispozicion nga organi përgjegjës shtetëror, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore, ku është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore, krijon një komision të posaçëm, i cili vlerëson kërkesat e subjekteve që përfitojnë nga programet e procesit të rindërtimit, në bazë të dokumentacionit përkatës dhe parashikimeve të këtij vendimi, si dhe harton listën e subjekteve që përfitojnë nga programet e procesit të rindërtimit.

- Pika 21, e VKM-së nr. 5/2020: “Për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programi i granteve të rindërtimit, në bazë të kritereve të përcaktuara në këtë vendim, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore ku është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore ose autoriteti përgjegjës krijon një komision të posaçëm, i cili vlerëson kërkesat në bazë të dokumentacionit të kërkuar, sipas këtij vendimi.”

Referuar parashikimeve të mësipërme si dhe Raportit me nr. 14506 Prot., datë 12.12.2024 të Komisionit të Posaçëm miratuar nga kryetari i bashkisë, Komisioni i Posaçëm në bazë të dokumentacionit përkatës dhe parashikimeve të legjislacionit në fuqi pas vlerësimit të dokumentacionit të të gjithë aplikantëve harton listën e subjekteve që përfitojnë nga programet e procesit të rindërtimit për Pallatin Nr.25.1 Rruga "Hysen Myshketa", në Njësinë Administrative Nr.3, i dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 Nëntor 2019, sipas relacionit si më poshtë vijon:

Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike, i ngritur me urdhër nr. 108, datë 12.03.2020 të Kryetarit të Bashkisë, ka kryer shqyrtimin dhe kualifikimin e dosjeve të pronarëve të apartamenteve të pallatit të ndodhur në Njësinë Administrative Nr.3, Rruga "Hysen Myshketa" Pallati Nr.25.1.

Ky dokumentacion dhe kjo listë e subjekteve përfituese i vihet në dispozicion Komisionit të Posaçëm nga Zyra e Posacme e Rindërtimi, nëpërmjet :

1. Raportit nr. 13438 prot. datë 15.11.2024 për Pallatin Nr.25.1 Rruga "Hysen Myshketa" ku kanë kualifikuar nëntë subjekte përfituese nga të cilat shtatë subjekt kanë aplikuar në platformën "Shtëpia ime" duke marrë gjendjen familjare të datës së aplikimit, si edhe dy subjekte që nuk kanë bërë aplikim tek platforma "Shtëpia Ime". Lidhur me dy subjektet që nuk kanë bërë aplikim tek platforma "Shtëpia Ime", Zyra e Posaçme e Rindërtimit ka shqyrtuar dhe i ka kualifikuar, duke marrë parasysh përbërjen familjare të datës 26 nëntor 2019.

Kjo listë e subjekteve përfiton nga programi i procesit të rindërtimit, në bazë të dokumentacionit përkatës dhe parashikimeve të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 904, datë 24.12.2019 "Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve mbi disa programe të procesit të rindërtimit", i ndryshuar.

Për sa më sipër, bazuar në legjislacionin e sipërpërmendur dhe procedurës së ndjekur nga Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike dhe Komisioni i Posaçëm, kërkohet:

1. Miratimi i listës së përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit për pallatin Nr.25.1, Njësia Administrative Nr.3, Rruga "Hysen Myshketa", i dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019, sipas Aneksit nr.1, pjesë përbërëse e këtij raporti.

Nr.	PRONARI	GJENDJE FAMILJARE SIPAS ÇERTIFIKATES	STRUKTURA E APARTAMENTIT QË DO PËRFITOHE
1	PERPARIM RECI, VOJSAVA RECI	5	3+1
2	SOKOL FAMA	5	3+1
3	JORIDA DOCI, LEONARD BOLLO	4	2+1
4	FATMIR FARRUKU, SABRIJE FARRUKU	4	2+1
5	PRANVERA FERHATI, VANDAN, FERHATI	4	2+1
6	ADEL KORBI	3	2+1
7	NAXHIJE ISMAILI	1	1+1
8	IZET MANJANI, NAZE MANJANI	4	2+1
9	AFËRDITA REÇEKU, GËZIM REÇEKU	7	3+1
10	PETRIT KONI, BAJAME KONI	3	2+1
11	GENTIAN PINA, IRIS PINA	3	2+1
12	GENC GJERGJI, ROVENA GJERGJI	3	2+1
13	JURGEN KARATI	1	2+1
14	BUJAR PERVIZI, ENERJETA, PERVIZI	4	2+1

KOMISIONI POSAÇËM:

Gentian	Kallmi	Kryetar	Robert Dervishi	Anëtar
Andri	Cerri	Anëtar	Diana Mandia	Anëtare
Klarita	Agasi	Anëtare	Lorenc Facja	Anëtar
Afroviti	Manthjo	Anëtare	Myslim Hasanaj	Anëtar